



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 353-18950/2025

Klinë, datë 24/06/2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit, nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 të dt.07.04.2010, e ne mbështetje të dispozitave të neneve 7 dhe 10 të Rregullores së Komunës së Klinës, nr.01-463-34997 /2021 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më Pak së Një Vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kryetari i Komunës sipas kërkesës- propozimit të Drejtorit të DUMM, nxjerr **këtë**:

V E N D I M

Për zëvendësimin e përkohshëm të anëtarit të komisionit për dhënien në shfrytëzim më pak së 1 vit të hapësirave publike

1. **Gjon Mrijaj**, caktohet përkohësisht anëtarë i komisionit për dhënien në shfrytëzim më pak se 1 vit të hapësirave publike, i cili e zëvendëson anëtarin e rregullt të komisionit **Ahmet Berisha** deri në kthimin e tij nga pushimi vjetor.
2. Komisioni benë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim më pak së një vit, si dhe i rekomandon kryetarit të komunës për nënshkrimin e kontratës.
3. Komisioni punën e vet e kryen në përputhje më dispozitat e Rregullores për Përcaktimin e procedurave të dhënies më pak së një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës, nr.01-463-34997/2021, si dhe dispozitat tjera ligjore dhe nënligjore pozitive te cilat rregullojnë këtë fushe.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm nga data e nënshkrimit të tij nga Kryetari i Komunës, i cili prodhon efekt juridik deri në kthimin e anëtarit Ahmet Berisha nga pushimi vjetor.

Te njoftohen:

- I përmendurit;
- Drejtoria e UMM;
- Anëtarët e komisionit;
- Zyra e Informimit, si dhe;
- Arkivi.



Kryetari,
Zenun Elezaj